



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:200604

Datë: 31.01.2020

Numri i dokumentit: 00801490

P.nr. 1001/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Ahmet Rexhaj, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Lindmire Begolli , në çështjen penale kundër të pandehurit Sh. H. nga, për shkak të veprës penale, "Ndertimi pa leje " nga neni 359 par.2 te KPRK-së , duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, PP/IL.nr.1740/19, të dt.31.10.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, publik dhe me gojë , me dt. 21.01.2020, të mbajtur në prezencën e të Prokurorit të shtetit Ardiana Veseli , te pandehurit Sh. H. , Av.Sali Mekaj , me dt 21.01.2020 ka mar dhe publikisht shpallë këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri Sh. H. i lindur me ne në fsh. K....., ku tani me vendbanim në rr..... pa nr. , i biri Ryshitit , nënës Faze , e gjinisë Ademaj , ka të kryer shkollën e mesme , me profesion pronar i, gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal, shqiptar , shtetas i Republikës së Kosovës , gjendet në liri,

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

- Me datë 17.05.2019 rreth orës 10:05 min në lagjennë si pronar-pergjegjës i subjektit “.....”bene ndërtim pa leje ndërtimi ne ate menyre qe i pandehuri përmes subjektit te lartëcekur vazhdon ndërtimin e objektit banesor edhe pasi inspektoriati komunal i ndërtimit përmes procesverbalit te dt.02.04.2019 dhe vendimit e datës 24.04.2019 dy here e kishte urdhëruar qe te pezullojë punën ndertimore dhe mos kryej asnjë aktvitet ndërtimor pa u pajisur me leje ndertimore por i njëjti kishte vazhduar me ndërtim.

-me çka ka kryer vepër penale, " Ndertim pa leje “ nga neni 359 par 2 te KPRK – se .

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 7,41,42,43,46,73, të KPK-së, nenit 359 par 2 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, të pandehurit Sh. H. i shqipton,

DENIM ME BURG

DHE GJOBË

I. Ashtu që te pandehurit Sh. H. i shqiptohet dënim me burg ne kohëzgjatje 6 (gjashtë) muaj

II. Me pëlqimin e te pandehurit dënimi me burg është zëvendësuar me dënim gjobe ne shumen prej nëntëqind (900) euro e te cilin është e obliguar që ta paguaj ne afatin prej 30 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i pandehuri i lartcekur dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimi me gjobë gjykata do ta zëvendësoi me dënim burgu, një ditë burgu i llogaritur 20 € të gjobës.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor ta paguajë shumën prej 20€ (njëzetë euro), si dhe në emër të programit për kompensimin e viktimave të krimit në shumë prej 30€ (tridhjetë euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet e kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për krime të përgjithshme ka ngrit aktakuzë PP/II.nr.1740/19, të dt.31.10.2019 , kundër të pandehurit Sh. H. nga, për shkak të veprës penale “ Nderim pa leje “ nga neni 359 par 2 te KPRK-së

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestarë me datë 21.01.2020, pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurores së PP/II.nr. 1740/19, të dt.31.10.2019, në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata është bindur se i pandehuri i ka kuptuar aktakuzën dhe të pandehurit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata e ka udhëzuar të pandehurin për rëndësinë dhe pasojat e pranimi të fajësisë, dhe i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar pasojat dhe benefitet e pranimi të fajësisë është e vërtet që unë që nga fillimi i kësaj procedure penale ndaj meje e kam pranuar veprën per arsyeje se punimet i kam filluar para se te pajisem me leje duke konsideruar se ne baze te kushteve te ndërtimit mund te përgatis terrenin , te hapi podrumin deri sa te pajisem me leje ndërtimorë për arsyeje se kjo është arsyeja që kem filluar pa u pajisur me leje, i kishte propozuar gjykatës që këtë rrethanë te merr si rrethanë lehtësuese me rastin e marrjes se vendimit mbi dënim.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, meqenëse i njëjti e ka pranuar fajin , duke i kuptuar pasojat e pranimi të fajësisë dhe në atë mënyrë vullnetare dhe pa ndonjë presion, konsideron se i njëjti pranim i fajësisë ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresa të lëndës.

Mbrojtësi i te pandehurit Sali Mekaj pranimi është bere me vullnetin e te pandehurit pas konsultimeve që i kemi pasur pranimin i fajësisë është i bazuar ne provat që gjenden ne shkresat e lendes konsideroj se gjykata do te merr vendim për pranimin e fajësisë e te pandehurit pasi që janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë te tillë.

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të pandehurit vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të pandehurit, pasi që ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

Duke pasur parasysh të lart cekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës konform nenit 253 të KPPK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPPK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave por gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre fakteve siç janë pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit si dhe duke pasur parasysh provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: dëshmitari M. Z. inspektor i ndërtimit ne Komunën e Pejës , raporti i policit H. K. i dt.17.05.2019 , procesverbali i dt.02.04.2019, inspektoratit te Komunës së Pejës, vendimi i fletëdorzimi i inspektoratit te Komunës se Pejës i dt.23.04.2019, deklaratata e te pandehurit te dhënë në polici me dt.17.05.2019 dhe me dt.15.10.2019 ne prokurori deklarata e inspektorit te ndërtimit M. B. e dhëne ne stacionin policor me dt.17.05.2019 dhe ne prokurori me dt.30.10.2019 dhe fotografit e vendit te ngjarjes , ka konstatuar se i pandehuri eshte fajtor per vepren penale si ne dispozitiv te aktgjykimit .

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjykata ka vendosur që të pandehurin Sh. H. ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe penalisht përgjegjës.

Duke vendosur mbi vendimin mbi dënim konform nenit 73 dhe 74 të KPRK-së me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, gjykata ka marrë për bazë disa rrethana që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit.

Si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjyqtari i vetëm gjykues e ka marrë pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, kërkim faljen , se është penduar për kryerje e kësaj vepre penale, se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale, si dhe premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryej ndonjë vepër tjetër penale. Ndërsa gjyqtari i vetëm gjykues, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese për të pandehurin.

Sipas bindjes së gjyqtarit të vetëm gjykues, dënimi i shqiptuar me gjobë ndaj të pandehurit Sh. H. e duke i marrë për bazë rrethanat e lart cekura, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë të pandehurit.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 41 të KPRK-së.

Konform nenit 463 par 1 dhe 2 te KPPRK- se palën e dëmtuar e ka udhëzuar ne kontest civil.

Duke u bazuar në nenin 450 të KPPRK-së, e obligoi të pandehurin në pagimin e paushallit gjyqësor.

Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit e obligoi të akuzuarin që të paguaj shpenzimet e viktimave të krimit.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPRK-së.

**NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË- Departamenti i Përgjithshëm
P.nr . 1001/19 te dt 21.01.2020.**

Sekretarja juridike

Lindmire Begolli

Gjyqtari

Ahmet Rexhaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2019:200604
Datë: 31.01.2020
Numri i dokumentit: 00801490